



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 mars 2012
Nr. ref.:RMP-HKL206/12

**VENDIM PËR REFUZIMIN E MASËS SË
PËRKOHSHME DHE
HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA**

në

Rastin Nr. KI 122/11

Parashtruesi

Bujar Reka, pronar i INTER STEEL LLC

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomë së Posaçme
të Gjykatës Supreme të Kosovës,
SSC-11-0148, të 15 qershorit 2011.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Bujar Reka nga Prishtina, pronar i INTER STEEL LLC, i përfaqësuar nga Interlex Associates l.l.c.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, SSC-11-0148, i 15 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa ka të bëjë me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) për të vazhduar me shitjen e pasurive të NewCo Llamkos Steel Assets (në tekstin e mëtejme: Llamkos) përmes tenderit një ofertuesi tjetër në procesin e privatizimit.
4. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Kushtetuese të caktonte masë të përkohshme për ta ndaluar AKP-në nga konkludimi i shitjes së Llamkosit pasi kjo do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm dhe të pakthyeshëm parashtruesit. Si alternativë, ai kërkoi që Gjykata ta obligojë Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ta regjistrojë një shënim *lis pendens* në aksionet e Llamkosit.

Baza juridike

5. Nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 32, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese më 14 shtator 2011.
7. Me urdhrin e Kryetarit, të 19 shtatorit 2011, gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
8. Me anë të letrës së 7 dhjetorit 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Odën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për parashtrimin e kërkesës dhe, ndër të tjera, kërkoi përgjigje.
9. Kërkesa për masë të përkohshme dhe kërkesa për regjistrimin e një *lis pendens* u shqyrtuan nga Gjykata në përbërje të plotë më 12 dhjetor 2011.
10. Oda e Posaçme më pas u përgjigj në korrespondencën e Gjykatës Kushtetuese më 14 dhjetor 2011.

Përmbledhje e fakteve

11. Llamkos ishte ndërmarrje shoqërore e shitur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, por shitja e planifikuar dështoi. Më 3 shkurt 2011, AKP vendosi t'i shiste asetet sërish. Kompania e parashtruesit ofroi 5.345.000 euro dhe ishte ofertuesi i dytë më i lartë. Ofertuesi i parë nuk e komplettoi shitjen. Parashtruesi u informua për këtë dhe se do të mund të kualifikohet si ofertues i suksesshëm pas bisedave me një përfaqësues të AKP-së.

12. Megjithatë, pas një komunikimi të shkurtër ndërmjet parashtruesit dhe AKP-së, parashtruesi u informua me letrën e 27 prillit 2011 se AKP-ja vendosi të mos ia kompletonte parashtruesit shitjen e Llamkosit. Më pas, ofertuesi i tretë deklaroi publikisht se e kishte fituar tenderin. Më vonë, më 3 gusht 2011, AKP bëri të ditur se ndërmarrjen ia kishte shitur një pale të tretë.
13. Më 17 maj 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë për një vendim gjyqësor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjithashtu e kontestoi vendimin e AKP-së për të mos ia kompletuar shitjen parashtruesit. Me vendimin e vet të 15 qershorit 2011, i cili parashtruesit iu dorëzua më 16 qershor 2011, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme e refuzoi kërkesën për vendim gjyqësor.
14. Para vendimit të Dhomës së Posaçme, AKP i shkroi parashtruesit më 1 qershor 2011, duke theksuar se *“Komisioni i likuidimit ka komunikuar me bankën [e parashtruesit] dhe ka fituar besimin se Inter Steel sh.p.k. në të vërtetë nuk posedon fonde të mjaftueshme të depozituara apo fonde të tjera për ta paguar çmimin e ofertës dhe për t'i përmbushur zotimet për investim”*.
15. Parashtruesi e mohon këtë dhe thekson se banka Raiffeisen askujt nuk i ofroi informata specifike lidhur me shumën e fondeve të depozituara në bankë. Parashtruesi pohon që banka Raiffeisen ofroi një formular standard të garancionit që e kishte përdorur më parë për qindra tenderë të AKM-së dhe AKP-së.
16. Më 29 qershor 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme, me të cilën kërkonte anulimin e vendimit të Dhomës së Posaçme.
17. Më 11 janar 2012, avokatët e parashtruesit i shkruan Gjykatës Kushtetuese dhe e njoftuan se pasi Kolegji i Apelit i Odës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës tashmë kishte nxjerrë një vendim, çështja ishte tani pa objekt shqyrtimi.

Pretendimet e parashtruesit

18. Pretendimet e parashtruesit janë siç janë cekur në faktet më sipër, domethënë që:
 - i) Procesi i privatizimit për Llamkosin ishte zhvilluar në mënyrë të padrejtë;
 - ii) Vendimi ishte bazuar në fakte të gabuara; dhe
 - iii) Ka pasur shkelje të neneve 32 [E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE] dhe 46 [MBROJTJA E PRONËS] të Kushtetutës në lidhje me nenin i të Protokollit dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore për shkak se Dhoma e Posaçme ia kishte mohuar parashtruesit të drejtën për ta marrë vendimin brenda një afati të arsyeshëm.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

19. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Kushtetuese të caktonte masë të përkohshme për ta ndaluar AKP-në nga konkludimi i shitjes së Llamkosit pasi kjo parashtruesit do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm dhe të pakthyeshëm.
20. Njëri prej kriterëve për caktimin e masës së përkohshme është nëse do të shkaktohen dëme të pakthyeshme dhe të pariparueshme.
21. Neni 116.2 i Kushtetutës përcakton:

Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

22. Neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

23. Nëse ndodh të gjendet shkelja e një të drejte kushtetuese, atëherë ai mund të jetë rasti që veprimi në dëme të mund të jetë mjet i mundshëm.

24. Megjithatë, pasi ankesa ende ishte në procedurë e sipër në Kolegjin për Apele të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ekzistonte mundësia që kontesti do të mund të zgjidhej në favor të parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullave 32, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për lejimin e një *lis pendens*;
- III. TA HEQË kërkesën nga lista dhe të mos ndërmarrë masa të tjera lidhur me të;
- IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani